



Mirësevini në Buletin Informativ të 2të të projektit EnerNETMob Interreg MED!

Evidenca nga projekti EnerNETMob

“Mobiliteti Elektrik në Zinxhirin Furnizues Ushqimor në Sicili”, Gazeta Ndërkombëtare për Studime Ekonomike në Bujqësi

Si pjesë e Aksionit Pilot 3, projekti EnerNETMob eksperimenton lidhjet e “halkës së fundit” për shpërndarjen e produkteve agro-ushqimore në distancë të shkurtër ndërmjet zonave rurale dhe zonave metropolitane dhe urbane. “Mobiliteti elektrik në zinxhirin furnizues ushqimor me distancë të shkurtër në Sicili” është studimi i parë për të zbuluar synimin e sipërmarrësve që operojnë në zinxhirin furnizues ushqimor me distancë të shkurtër në Sicili për të adoptuar mobilitetin elektrik brenda biznesit të tyre. Rezultatet paraqetë u diskutuan për të zgjeruar njohuritë ekzistuese të sipërmarrësve dhe politikëbërësve në zinxhirin furnizues ushqimor me distancë të shkurtër në Sicili, duke shtruar në këtë mënyrë rrugën për kërkime të tjera në këtë fushë.

Lexoni artikullin e plotë [këtu](#) (versioni anglisht).

“Sfidat dhe Zgjidhjet për një Qëndrueshmëri më të Madhe në Sistemet e Transportit Agro-Ushqimor dhe Sistemet e Logjistikës”

Sektori i shpërndarjes po merr rëndësi të madhe në shpërndarjen e produkteve ushqimore pasi po shndërrohet në një komponent të zakonshëm të konsumit. Sidoqoftë, rritja e këtij sektori ka ndikuar në mënyrë të pashmangshme kërkesën për transport mallrash, veçanërisht në zonat urbane. Qëllimi i këtij studimi ishte investigimi i faktorëve kryesorë që ndikojnë adoptimin e strategjive të qëndrueshme, ndërmjet të cilave edhe elektro-mobiliteti, në sektorin e shpërndarjes së mallrave ushqimore dhe çfarë pengesash hasen aktualisht. Ky studim është financuar nga projekti EnerNETMob.

Mund të lexoni artikullin e plotë [këtu](#) (versioni anglisht).

“Kuardri Rregullator dhe i Politikave të BE-së mbi elektro-mobilitetin”

EnerNETMob ka paraqitur një raport të integruar mbi politikën, rregulloret dhe Direktivat e BE-së dhe zbatimin e tyre në nivel kombëtar. Raporti përmbledh rezultatet e analizave lokale të bëra nga secili partner i projektit në vendin/rajonin e tij dhe përbëhet nga 16 raporte kombëtare ose lokale të hartuara nga secili partner i projektit sipas një kuadri dhe çështjesh të përbashkëta. Qëllimi është krahasimi i kuadrit ligjor të politikave të zbatuara nga secili shtet anëtar, me qëllim që të hartohen pika referimi për udhëzimet dhe standartet teknike që do të adoptohen në zbatimin e Rrjetit Mesdhetar Ndër-rajonale të Elektro-mobilitetit dhe Rrjeteve të ndërlidhura të Infrastrukturasë Përkatesë.

Lexoni raportin [këtu](#) (versioni anglisht).

“Analiza e Kuadrit Lokal mbi Elektro-Mobilitetin dhe Gjendja Aktuale e Sektorit Energjitik”

EnerNETMob ka paraqitur një raport mbi Analizën e Kuadrit Lokal mbi Elektro-mobilitetin dhe Gjendjen Aktuale të Sektorit Energjitik sipas analizës së rregulloreve dhe udhëzimeve të përbashkëta planifikuese. Kjo analizë përcakton: Gjendjen aktuale të kërkesës dhe ofertës për transport në të gjithë vendet/rajonet e përfshira, duke u fokusuar në zhvendosjet interurbane dhe në integrimin e elektro-mobilitetit me terminalin intermodale. Aty ku është e mundur, është bërë edhe analiza e rrjeteve lokale mbi gjendjen aktuale të kërkesës dhe ofertës për energji, duke u fokusuar në sistemet e rinovueshme të energjisë në koherencë me autoritetet lokale/rajonale/kombëtare.

Lexoni raportin [këtu](#) (versioni anglisht).

E-mobility në Itali: Cila është gjendja aktuale? Intervistë me Federico Caleno – Drejtor i Enel X e-mobility

Enel X është një ndër aktorët më të rëndësishëm për mobilitetin e qëndrueshëm në Itali. Në sajë të një numri të lartë stacionesh karikimi, njerëzit mund të udhëtojnë në Itali me një makinë elektrike.

Pyetëm Federico Caleno, drejtorin e Enel X e-mobility, në lidhje me gjendjen, skenarët e mundshëm dhe sfidat për të ardhmen të elektro-mobilitetit qysh me lançimin e Planit Infrastruktural në Nëntor 2017.

Lexoni intervistën e plotë [këtu](#) (versioni anglisht).

Azhornime mbi zbatimin e projekteve pilot

Planet e Elektro-Mobilitetit të Qëndrueshëm (SEMPs)

Projekti EnerNETMob po zbaton Planet e Elektro-Mobilitetit të Qëndrueshëm (SEMPs) nëpërmjet zhvillimit të aksioneve pilot dhe testimit të rrjetit ndër-rajonale të elektro-mobilitetit me platformën ICT të zhvilluar nga CIMNE. Nëpërmjet projektit EnerNETMob, pikat e karikimit do të vendosen në qytete të ndryshme dhe terminale intermodale. Fleksibiliteti i makinave elektrike do të testohet për zhvendosje interurbane si edhe për ato ndërkufitare, me një diapazon prej 30 deri 160 km dhe më shumë. Objektivi është që partnerët e projektit t'i zbatojnë aksionet pilote gjatë gjysmës së parë të 2021. Ndërkohë, kanë nisur tashmë procedurat e prokurimit për blerjen/qeramarrjen/leasing të makinave elektrike po ashtu si edhe ka nisur faza testuese e ngarjes së makinave elektrike. Rajoni i Thesalisë dhe Porti i Barit qenë të parat që bënë makinë elektrike në kuadër të projektit EnerNETMob. Faza e ardhshme ka të bëjë me punimet e nevojshme për testimin si edhe për instalimin e infrastrukturës së nevojshme dhe sistemeve ICT. Në lidhje me sistemet ICT, është kryer tashmë një studim tregu për finalizimin e termave të referencës për prokurimin e platformës ICT. Vlerësimi i rezultateve të testimit të aksioneve pilot do të mundësojë përmirësimin e SEMP.

Takimet dhe eventet e projektit EnerNETMob



Eventi “Regional Open Day” i projektit EnerNETMob

Aktiviteti informues “E ardhmja e Elektro-Mobilitetit në Rajonin e Thesalisë” u zhvillua më 25-26 janar 2020 në Larisa, Greqi në kuadër të organizimit të eventeve “Regional Open Days” të projektit EnerNETMob. Eventu i mundësoi një numri të madh pjesëmarrësish të vizitonin hapësirën e dedikuar posaçërisht informimit rreth përfitimeve të elektro-mobilitetit dhe veprimtarive të ardhshme të planifikuara nga Rajoni i Thesalisë. Gjithashtu pjesëmarrësit patën mundësinë të provonin “udhëtimin” me një makinë elektrike duke përdorur syzet VR dhe pjesëmarrjen në një garë për të fituar një udhëtim për 2 vetë me makinë elektrike!




“Takimi i 2të Kombëtar i Grupit të Punës dhe Aktivitet Promovues i Rrjetit Intermodal në Shqipëri”

Përfaqësues të projektit EnerNETMob morën pjesë në “Takimin e 2të Kombëtar të Grupit të Punës dhe Aktivitetin Promovues të Rrjetit Intermodal në Shqipëri” organizuar më datë 29 janar 2020 nga Instituti i Transportit. Në event morën pjesë një numër i madh polësh interesanti nga Ministria e Infrastrukturasë dhe Energjisë, autoritete publike kombëtare dhe rajonale, ofrues shërbimesh, SME, OJQ, agjensitë transporti, universiteti etj.



Takimi i 5-të i projektit EnerNETMob

Takimi i 5-të i projektit EnerNETMob u përshtat me situatën për shkak të Covid-19 dhe u zhvillua online më 5 qershor 2020. Në takim morën pjesë të gjithë partnerët të cilët diskutuan mbi progresin e projektit dhe hapat në të ardhmen.



Eventi për zhvillimin e kapaciteteve “ESMARTCITY Transnational Policy Stakeholder”

Projekti EnerNETMob mori pjesë në eventin për zhvillimin e kapaciteteve “Transnational Policy Stakeholder” organizuar më 6-7 korrik 2020 në kuadër të projektit ESMARTCITY. Gjatë eventit u prezantuan aktivitetet dhe instrumentat e përdorur nga projekti EnerNETMob si edhe lidhja e tyre me konceptin ‘smart city’ gjatë sesionit “Qytetet Smart dhe Elektro-Mobiliteti në Qytetet Smart”. Projekti EnerNETMob u përfaqësua nga Dynamic

Mbështetje për ‘Forum in Circle the Med’

Forumi Circle the Med përfaqëson një instrument drejt transportit të qëndrueshëm, duke promovuar modele të reja prodhim-të konsum dhe iniciativë të biznesit qarkullues. Sesionet e dedikuara Mobilitetit të Qëndrueshëm, Qyteteve Smart dhe Elektro-mobilitetit do të zhvillohen më 12 nëntor 2020. Ndërkohë, në kuadër të kësaj iniciative kanë filluar të organizohen një seri debatesh virtuale, duke ftuar ekspertë dhe politikëbërës të ekonomisë qarkulluese. Projekti EnerNETMob mbështet eventin në platformën e qyteteve smart.

Eventet virtuale të vitit 2020 lidhur me mobilitetin elektrik

Si pasojë e masave të marra për shkak të përhapjes së coronavirus, shumë evente të planifikuara për t'u zhvilluar në 2020 po zhvillohen si evente virtuale, ndërkohë që disa evente janë anuluar. Sidoqoftë, shumë evente të tjera po zhvillohen në mbarë botën! Lista e eventeve dhe koha e organizimit të tyre (me pjesëmarrje virtuale apo fizike) që trajtojnë mobilitetin elektrik përgjatë 2020 jepet [këtu](#) (versioni anglisht).

Bashkohuni me rrjetin EnerNETMob

Projekti EnerNETMob numëron 16 partnerë nga 12 vende mesdhetare: Greqia, Malta, Italia, Qipro, Shqipëria, Kroacia, Sllovenia, Portugalia, Mali i Zi, Spanja, Franca dhe Austria, duke nxitur rritjen e zgjidhjeve të elektro-mobilitetit në rajonin e Mesdheut. Bashkohuni rrjetit tonë!

Facebook: [@enernetmob](#)
 Twitter: [@EnerNETMob](#)

Mësoni më tepër mbi projektin EnerNETMob: enernetmob.interreg-med.eu

THE ENERNETMOB PARTNERSHIP

- Region of Peloponnese-Department of Management for Development Planning, (LP)
- Authority of transport in Malta
- RAM Logistica Infrastruttura e Transporti s.p.a.
- Ministry of Transport, Communications and Works
- Albanian Institute of Transport
- Region of Thessaly-Department of Development and Planning
- County of Primorje and Gorski Kotar
- University of Palermo- Department of Agricultural, Food and Forest Sciences
- Regional Development Agency of Northern Primorska Ltd. Nova Gorica
- Energy and Environment Agency of Arrabida
- Free Municipal Consortium of Ragusa
- Dynamic Vision P.C, Athens
- Port of Bar Holding company
- CIMNE, International Center for numeric methods in engineering-Barcelona
- CAPENERGIES, Aix-en-Provence, France
- FORSCHUNGSGES ELLSCHAFT MOBILITÄT - Austrian Mobility Research FGM - AMOR

